

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditësit "E." shpk me seli në F.K., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajturnë prani të paditësit dhe nëmungesë të të paditurës, me datë 5 shtator 2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesë padia e paditësit "E." shpk me seli në F.K..
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, nr. **A-12/14**, i datës **02.05.2014** dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Paditësimet padinë e datës 13 qershor 2014 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës nr. A-12/14 i datës 02.05.2014, me të cilin i është refuzuar ankesa si e pabazuar. Pretendon se R.B. nga Komuna e Prishtinës është pajisur me leje të ndërtimit nr. 05-351-460073 të datës 12.02.2013, ndërsa paditësi "E." shpk me datën 26.02.2013 ka blerë nga R.B. pronën në fjalë për të cilën posedon edhe me dokumentacion. Me tutje thekson se leja e ndërtimit konsiston në lejimin e ndërtimit të objektit afarist prej 6716.56 m² dhe në të njëjtin objekt është paraparë shtesa prej 160 m². Me datën 31.12.2013, Drejtoria e Inspektionit, Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës me vendimin nr. 356-82409 urdhëron paditësen që shtesën elartpëmendur prej 160 m² ta rrënoj menjëherë duke mos pasur parasysh Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, neni 34 paragrafi 3 i cili parasheh se inspekcioni ndërtimor do të përcaktoj kohën e mjaftueshme brenda së cilës poseduesi i duhet ta rrënoj objektin. Po ashtu thekson se paditësi si pasoj e shkeljes së dispozitivit ka pësuar dëme materiale. Andaj kërkon nga gjykata që padia e paditësit të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i të paditurës të anulohet.

Në seancën e datës 5 shtator2018, palët janë ftuar me rregull, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar e paditura, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar. Andaj, gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e ka mbajtur në mungesë tëpalës se paditur.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në shqyrtimin kryesor të datës 05.09.2018 ka bërë administrimin e provave dhe atë:vendiminA-12/14 të datës 02.05.2014, aktvendimin e Komunës së Prishtinës nr. 05-351-46073 të datës 12.02.2013, certifikata nr. 011-953-245502/13 e datës 20.12.2013, ankesa e RBKO e datës 24.01.2013, lexohetkërkesanga RBKO me nr. prot. 05-035-77e datës 03.01.2014, vendimi i Komunës së Prishtinës, nr. 356-82409 i dates 31.12.2013, procesverbali për kontrollin inspektues nr. 356 i datës 31.12.2013.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 tëLKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimet e paditëses në seancësi dhe përgjigjen e të paditurës në padi dhe pas shqyrtimit tëtë gjithave shkresave tjera të lëndës konstatoise kërkesëpafia e paditësitështë e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha atoakte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime,përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj.

Ndërsa në nenin 86.1 të këtij ligji, përcaktohet se:

"Arsyetduhettëformulohenqartëdhjetëpërfshijnshpjegimet e bazësligjoredhefaktiketëaktit".

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata e ka obliguar tëpaditurën që të ofrojë prova relevante bashkë me përgjigjen në padi .

Pavarësisht detyrimit, e paditura as me përgjigje në padi, as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ka ofruar asnjë provë me të cilat do ta mbështes pretendimet e saj

Në bazë të nenit 63të LKA-së, dispozitat e LPK-sëdo të zbatohen përshtatshmërishtnë rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konflikt administrativ. Andaj, bazuar në këtë gjykata iu referua nenit 7.1, ku përcaktohet se:

"Palëtkanëpërdetyrëtëparaqesintëgjithafaktetmbitëcilatimbështesinkërkesat e vetadhepropozojnëprova me tëcilatkonstatohenfaktet e tilla

Ndërsa në nenin 7.3 të këtij ligji, përcaktohet se

Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në fakte dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave tëtë provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin me përpikëri të procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.Andaj në këtë kuptim gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në kundërshtim me ligjin, kur as me përgjigje në padi as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ka ofruar provat me të cilat ka mbështetëvendimin kontestues, si rrjedhojë, paditësit nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet rreth tyre.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të nxjerrë vendim të drejtë.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43,46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.907/14, medatë5 shtator 2018

Procesmbajtësja Gjyqtarja

Nazmije Beka Arjeta Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tënjëtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.